

VENDIM
Nr.578, datë 27.8.2004

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.322, DATË 21.5.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA
INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MASËN E MBULIMIT
TË ÇMIMIT TË TYRE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të vendimit nr.322, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Masa e mbulimit të çmimit të barnave të listës së barnave të rimbursueshme për kategorinë e pensionistëve të jetë 100 për qind."

2. Efektet financiare për vitin 2004 të përballohen nga fondi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 28.5.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano